



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.162 dt.29.09.1997

**PER
KRITERET E VECANTA TE SHPERNDARJES SE
NDIHMAVE HUMANITARE USHQIMORE**

Në zbatim të V.K.M. Nr.166, dt.11.04.1997 “Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare” të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.261, dt.14.06.1997 “Për mënyrën dhe kriteret e shpërndarjes së ndihmave humanitare ushqimore.....”, të informacionit Nr.93, dt.29.07.1997 të Zyrës Rajonale Tiranë me propozim të Drejtorisë së Shërbimeve të Jashtme të Bashkisë së Tiranës ; Këshilli Bashkiak

VENDOSI

Të miratojë kriteret e veçanta për shpërndarjen e ndihmave humanitare ushqimore si më poshtë :

1.Për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike

Të përfitojnë ndihmë humanitare

1.Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe sipas mundësisë që disponohet, midis këtyre familjeve mund të përfitojnë disa herë ndihma humanitare ato familje që janë me të varfërat.

2.Familjet që kanë anëtare me paaftësi mendore fizike.

2.Për familjet që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike

Të përfitojnë ndihmë humanitare

1.Familjet e varfëra që kanë të ardhura deri në nivelin e ndihmës ekonomike.

2.Familjet e varfëra që në përbërje të tyre kanë anëtarë të sëmurë, anëtarë me paaftësi mendore ose fizike dhe anëtarë invalidë.

3.Familjet e varfëra që, për arsye të ndryshme nuk plotësojnë kushtet e legjislacionit në fuqi për tu trajtuar me ndihmë ekonomike.

3.Përpilimi i listave emërore të familjeve që përfitojnë ndihma humanitare.

1.Listat emërore të familjeve **të numrit 1** të përpilohen nga administratorët shoqërorë të Njësive Administrative të qytetit të Tiranës.

2.Listat emërore të familjeve **të numrit 2** të përpilohen nga “**Komisioni i shpërndarjes së ndihmave humanitare**” i Njesisë Administrative i përbërë nga **Administratori, Administratori Shoqëror, Ekonomisti, N/Administratorët e çdo Njësie Administrative.**

KRYETARI

ORHAN SAKIQI